



FONDI SHOIPTAR I ZHVILLIMIT
FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Për: Bashkimin e Operatoreve Ekonomike “Casanova + Hernandez Architecten”, me NIPT L82016014E, me adrese: Rruga "Ibrahim Rugova", Pallati 17, H3, Apt. 12, Tirane, dhe “Geosat Group” shpk, me NIPT K21624005I, me adrese: Rruga “Deshmoret e 4 Shkurtit” pallati i ri 19, Tirane, me kryesuese shoqerine “Casanova + Hernandez Architecten”.

Procedura e prokurimit: “Sherbim Konsulence”

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-90640-10-19-2018.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Projektimi i Zonës së Plazhit Durrës”.

Fondi limit: 41.624.734 (dyzet e një milion e gjashtëqind e njëzet e katër mijë e shtatëqind e tridhjetë e katër) lekë pa TVSH.

Publikime të mëparshme: Nuk ka patur.

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues:

NR	SHOQERIA
1	JV ARCHISPACE & GJEOKONSULT&CO
2	JV CASANOVA+HERNANDEZ ARCHITECTEN & GEOSAT GROUP
3	JV INSTITUTI DEKLIADA - ALB & CEC GROUP
4	JV PNI-2001 & GK & UTS-01
5	JV SPHAERA & KLODIODA

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Bashkimi i Operatoreve Ekonomike “Archispace” shpk & “Gjeokonsult&Co” shpk per arsye se:

Nuk ka paraqitur kontraten e punes per drejtuesin e projektit Tomor Luzati, ne kundershtim me kerkesen 2.3.3 per kualifikim ku, nder te tjera citohet: *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale per stafin kryesor, operatoret ekonomik duhet te paraqesin diplomat, CV dhe kontratat e punes”*.

Shoqeria “Archispace” shpk nuk ploteson kerkesen per kualifikim lidhur me shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri, pasi nuk ka paraqitur vertetimin perkates per likuidimin e detyrimeve per muajin Shtator 2018, muaj i maturuar ne daten e hapjes se ofertave.

2. Operatori Ekonomik “Studio B&L” shpk per arsye se:

Nuk ploteson kerkesen per kualifikim lidhur me shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri, pasi nuk ka paraqitur vertetimin perkates per likuidimin e detyrimeve ne emer te shoqerise “Studio B&L” shpk. Ka paraqitur nje vertetim se zoti Ermal Blea ka shlyer detyrimet ndaj OSHEE per kontraten TRIB030355033600 si dhe nje kontrate qeraje sipas se ciles Zoti Ermal Blea i jep me qera operatorit Ekonomik “Studio B&L” shpk nje apartament me siperfaqe 70 metra katror. Ne kerkesen per kualifikim citohet se Operatori Ekonomik duhet te paraqese *“Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri”*. Dokumentat e paraqitur vertetojne se operatori ekonomik nuk ka detyrime lidhur me kontraten TRIB030355033600, por nuk vertetojne se nuk ka kontrata apo detyrime te tjera.

Nuk ploteson kerkesen 2.3.4 per kualifikim lidhur me disponimin e pikave te kerkuara te licenses nga ana e shoqerise, pasi nuk disponon pikat e licenses 3/a, 4/c,j, 5/b,c, 6/a, 8/a, 10/e dhe 11/a.

Ne dokumentat e ngarkuara ne sistemin elektronik te prokurimeve kjo shoqeri ka paraqitur edhe disa dokumenta ne gjuhe te huaj per operatore te huaj. Duke qene se nuk eshte paraqitur asnje marreveshje bashkepunimi dhe prokure me keto shoqeri te huaja, komisioni nuk i mori parasysh keto dokumente.

Duke qene se keto te meta jane thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me shqyrtimin e dokumentave te tjera per kualifikim.

Ne fazen e dyte (fazen e propozimeve teknike) paraqiti propozim Bashkimi i shoqerive “Casanova + Hernandez Architecten” dhe “Geosat Group” shpk dhe Bashkimi i shoqerive “PNI - 2001” shpk, “G&K” shpk dhe “UTS - 01” shpk.

Vlerat e ofertuara pas hapjes se propozimeve financiare ishin si me poshte:

- Bashkimi i shoqerive “Casanova + Hernandez Architecten” dhe “Geosat Group” shpk paraqiti oferte per realizimin e projektit ne shumen 39.372.500 (tridhjetë e nente milion e

treqind e shtatedhjetë e dy mijë e peseqind) leke pa tvsh ose 47.247.000 (dyzet e shtate milion e dyqind e dyzet e shtate mijë) leke me tvsh dhe u vlerësua ne total me 99,34 pike.

- Bashkimi i shoqerive “PNI - 2001” shpk, “G&K” shpk dhe “UTS - 01” shpk paraqiti oferte per realizimin e projektit ne shumen 38.075.000 (tridhjetë e tete milion e shtatedhjetë e pese mijë) leke pa tvsh ose 45.690.000 (dyzet e pese milion e gjashteqind e nentedhjetë mijë) leke me tvsh dhe u vlerësua ne total me 93,6 pike.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “Casanova + Hernandez Architecten”, me NIPT L82016014E, me adrese: Rruga "Ibrahim Rrugova", Pallati 17, H3, Apt. 12, Tirane, dhe “Geosat Group” shpk, me NIPT K21624005I, me adrese: Rruga “Deshmoret e 4 Shkurtit” pallati i ri 19, Tirane, me kryesuese shoqerine “Casanova + Hernandez Architecten”, se oferta e paraqitur nga ana juaj ne shumen 39.372.500 (tridhjetë e nente milion e treqind e shtatedhjetë e dy mijë e peseqind) leke pa tvsh, vlerësuar me 99,34 pike, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Fondit Shqiptar të Zhvillimit me adrese: Rruga “Sami Frashëri”, Nr.10, Tiranë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 15 ditësh nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) siç parashikohet në nenin 49 të ligjit nr. 9643, date 20.11.2007 “Për prokurimin publik”.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 15.01.2019.

Ankesa: Ne daten 09.11.2018 paraqiti ankim bashkimi i Operatoreve Ekonomike “Archispace” shpk & “Gjeokonsult&Co” shpk. Ankimit ju kthye pergjigje ne daten 09.11.2018 duke e refuzuar ate. Bashkimi i Operatoreve Ekonomike “Archispace” shpk & “Gjeokonsult&Co” shpk paraqiti ankim ne KPP. Ne daten 07.12.2018 me vendimin nr 825/1 prot KPP lejoi vazhdimin e procedures.